

Pam Dawes

Intervistë 23 shtator, 2016

Ishin pesë djem në një bar, ata e quanin veten “Katolikët e këqinj”, ata thjesht qëndronin së bashku dhe shikonin lajmet për eksodin në ekranin e televizorit dhe menduan, “Çfarë të bëjmë ne? Të pijmë edhe nga një apo të bëjmë diçka tjetër?” Ata vendosën të bëjnë diçka tjetër. Ata udhëhoqën një projekt të konvojit humanitar¹, 15 ose 16 kamionë u nisën tri javë më pas, jo për Kosovë, por për Shqipëri, në kampet e refugjatëve.

Ishte e Premtja e Shenjtë kur ata ishin në (këtë) bar. Ishte kohë Pashkësh. Kam shumë respekt për ta. Shumica e atyre djemve ishin bartës të biletave të Manchester United dhe ajo ishte sezona jonë më e mirë, ekipi ishte gati të fitojë tripletin e trofeve - tre turne të mëdhenj - dhe në vend se të shkonin në ndeshje futbolli, djemtë filluan të shkonin në salla kishash. Ky projekt i përshkoi jetërat e tyre në tërësi, dhe ata që gjatë ditës ishin në punë, punonin në projekt gjatë natës.

Unë isha një nga djemtë në bar, iu bashkova ekipit në javën e dytë. Lëvizi shumë shpejt, kamioni kishte aq shumë ndihma sa që ushtria na doli në ndihmë. Unë isha duke bërë një punë tjetër, isha duke zhvatur, që nënkupton të marrurit e gjërave për asgjë. Dhe kontaktova ushtrinë e iu thashë se kishim nevojë për ndihmë. Ata thanë, “Nuk do të vijmë të veshur në uniforma, por do të vijmë gjatë natës”, sepse në ishim nismë e bamirësie dhe nuk ishim të lidhur me ushtrinë. Por ushtria na ndihmoi t’i shkarkojmë kamionët.

Kjo mund të përfundonte si një përgjigje humanitare, por refugjatët u evakuuan për në Mbretërinë e Bashkuar, mendoj (rreth) 2400 prej tyre, dhe shumë prej tyre kishin persona me aftësi të kufizuara në familje, disa ishin të plagosur, disa të sëmurë rëndë, me leukemi, dhe kishin nevojë të shkonin direkt në spital.

Ndihma e Manchesterit në Kosovë [Manchester Aid to Kosovo] mori një fokus të ri, për t’i mbështetur ata në komunitetin tonë. Kishte shumë fëmijë ndër ta, shumë ishin të plagosur rëndë, disa i kishin mbijetuar ndonjë masakre, ishin gjuajtur shumë herë. Ne arritëm ti njohim familjet mirë dhe vite më vonë filluam të prekeshim nga sukcesi i rimëkëmbjes së tyre. Kur ata fëmijë u rritën, piktura e tyre dukej jetë shumë të mira në Mbretërinë e Bashkuar, dhe disa prej tyre u kthyen në Kosovë.

U interesova në intervistën me Riza Krasniqin, të cilën e lexova në faqen tuaj të internetit, sepse gjithmonë kam qenë e interesuar për të ditur rreth Anton Çettës. Lexoja se çfarë thotë ai rreth pajtimit të gjaqeve, çlirimit të Kosovës, dhe dashurisë që rinia e ka për Kosovën: nëse e treta nuk do të arrihej, e para dhe e dyta do të ishin të padobishme, shteti do të vdiste megjithatë. U preka nga ajo se sa shumë të

¹ Ang. Humanitarian Convoy, një grup mjetesh udhëtimi i cili bart ndihma për në vendet në nevojë, zakonisht nën përcjelljen e rojave ushtarake.

rinjtë e donin Kosovën kur e vizitonin atë nga Manchesteri, dhe sa shumë kënaqësi iu jipte vizita dhe se si ata u kthyen në Kosovë e i morën aftësitë e tyre, edukimin e tyre të mirë, dhe diku më tutje edhe para, në Kosovë.

Ideja e historisë gojore erdhi shumë më vonë. Në fakt, ishte diçka që dëgjova në BBC Radio 4 teksa po vozisja. Ishte Fondi i Lotarisë së Trashëgimisë, pjesërisht i financuar nga Lotaria, por më shumë një iniciativë e udhëhequr nga qeveria, duke thënë se historia gojore mund të mos jetë çfarë të gjithë imagjinojnë, ajo mund të jetë histori e ndodhur së fundmi, mund të jetë historia e një organizate, një grupi, një komuniteti. Këmbanat filluan të binin. Ne mund të gjenim mbështetje dhe të xhironim përvojën e Kosovarëve në Manchester, historia e rëndësishme e përgjigjes së mëshirshme të qytetit ndaj një krize humanitare.

Ishte edhe më e rëndësishme kur gjërat u bënë të ashpra këtu, me rritjen e grupeve anti-imigrante. Ishte shumë e rëndësishme të tregohet historia se si qeveria dhe udhëheqësia lokale kishin punuar së pashku në një krizë refugjatësh dhe po, numri kishte qenë i vogël, por ne do të mund të tregonim se nëse nevojat takohen dhe burimet shpenzohen, rimëkëmbja, rehabilitimi dhe kontributi që do t'i kthehen mbrapshtë shoqërisë do të jenë fantastike.

Ishte një histori pozitive e shtetit tonë dhe unë shkova në Fondin e Lotarisë së Trashëgimisë për t'iu thënë atyre se unë dëshiroja të tregoja historinë e MaK dhe të xhiroja përgjigjen e Manchesterit, dhe ata më thanë "Bëje", dhe kështu i trefishuan paratë të cilat iu kishim kërkuar. Ishte një përgjigje shumë pozitive, veçanërisht për faktin se qeveria ishte në pozitën e donatorit. Ne kishim mbështetje fantastike, ata na dhanë këshilla shumë të mira, ata na krijuan kontakt me një specialist i cili ishte i aftë të na udhëhiqte përgjatë projektit, një anëtar të Qendrës Burimore për Raporte Racore, Ahmed Iqbal Ullah [Ahmed Iqbal Ullah Race Relations Resource Center], e emëruar në bazë të një djali nga Bandladeshi të vrarë në një krim racist në një kënd lojërash në Manchester.

Në fillim, ne organizuam një ekspozitë të projektit tonë të historisë gojore në Muzeun e Historisë së Popullit [Pepole's History Museum]. Ne vendosëm të shtojmë "Kirurgu në Ushtrinë Britanike" [Surgeon in the British army] në intervistën me Davidin, dhe kur e bëmë atë, e bëmë për të gjithë, dhe ishte një hap i rëndësishëm, ne morëm angazhimin dhe statusin e secilit person, dhe ajo i preku kosovarët të cilët erdhën ta shohin atë [ekspozitën]. Po, ne jemi kështu, ai është një montazher filmash, ai është një regjisor, dhe ai është udhëheqësi i MaK...Kur njerëzit panë se po trajtoheshin me shumë dinjitet, ata dëshironin të mernin pjesë dhe projekti u rrit. Shumë njerëz erdhën, dëshironin të përfshiheshin, sidomos nga të rinjtë të cilët ishin shkolluar këtu, ata thanë se dëshironin t'i përdornin xhiruesit vetë, ata filluan të shkruajnë, filluan të xhirojnë familjet rreth tavolinës, dhe ajo ishte diçka: ata morën apetit për të xhiruar historinë në këtë formë.

E dija se për shumë kosovarë që po bënë xhirimet ishte shumë e vështirë sepse ne po flisnim rreth të kaluarës. Ata nuk dëshironin të na thonin jo, ata mund të shihnin vlerën e projektit por ndiheshin jo të qetë rreth tij, Ata thanë se do të më lejonin mua t'i intervistoj ata. Kam qenë e përfshirë në bamirësi për 17 vjet dhe gjithashtu kam qenë e përfshirë në gjykimet e krimeve të luftës, ku kam mbështetur viktimat. Ata e dinin se nuk duhej të më shpjegonin çdo gjë.

Kam qenë e ndikuar nga një dokumentar mbi Holokaustin, ku përdorej një metodë e caktuar për të arritur tek detajet në një intervistë. Nganjëherë ti i jep shumë liri subjektit dhe kjo është e mrekullueshme, por unë mendoja se informacioni faktik duhej të fitohej nga të rinjtë të cilët ishin ndoshta dymbëdhjetë vjet, ose diçka e tillë gjatë luftës, dhe të rinjtë kishin kujtime shumë prexize të fshatrave të tyre, të asaj që kishte ndodhur. Unë doja që ajo të ishte pjesë e projektit tonë. Kishim nevojë për disa xhirime, të cilat në atë kuptim, ishin xhirime historike. Unë mësova, dhe njerëz të tjerë mësuan më shumë për atë që kishte ndodhur në spastrimin etnik, nëpër çka kaluan njerëzit që ishin të prekur nga ai, duke u dashur të lëvizin nga një shtëpi në tjetrën, të fshihen, shpesh të vetëdijshëm për kërcënimin nën të cilin gjendeshin prindërit e tyre, prindërit e tyre ishin marrë...më shumë llogari të detajuara zgjeruan kuptimin tim të asaj se çfarë është të jesh subjekt i një spastrimi etnik.

Kemi disa portrete serioze në bardhë dhe zi me xhirime, por gjithashtu keni mundësinë t'i shihni njerëzit me familje në xhirime me ngjyra. Besim Kadriu ishte i plagosur tmerrshëm dhe fytyra i ishte rindërtuar në Manchester. Kur e sheh atë me gruan e tij dhe katër vajzat në xhirim me ngjyra, një familje e bukur, është shumë lartësuese. Njerëzit e evakuuar këtu mendojnë se sektori "shokët dhe familja" është shumë inkurajues, është lartësues.

Mund të përfundonte në Muzeun Historik të Popullit brenda disa muajsh, por ne vendosëm ta bëjmë atë të shumëpërdorshme. Ideja është ta dërgojmë në vende të tjera, për shembull në shkolla dhe vende të punës. Është një ekspozitë që mbartë historinë gojore në ambiente të ndryshme, mund të udhëtojë jashtë shtetit, mund ta dërgojmë edhe në Kosovë. Na kanë ftuar në një spital të fushës, ishte shumë interesante për ushtarët ta shihnin atë, shumë rimëkëmbje kanë ndodhur për nder të KFOF dhe kjo është një histori shumë pozitive për Ushtrinë Britanike, e cila ishte e interesuar ta shfaqte ata tek njerëzit të cilët do të shkonin për të shërbyer diku tjetër.

Kemi një projekt tjetër, një projekt të suksesshëm tekstili, i cili është i ndikuar nga puna e bërë nga Bogujevci, kushëriri i Sarandës, duke përdorur një zog si simbol të lirisë, të qëndisura nga grupe të grave me tekste nga historia gojore. Zogjtë janë në formatin 3D, të qëndisur nga gra të cilat nuk kanë fituar para kurrë në jetën e tyre. Ato bënë 240 zogjë, por tani janë duke qëndisur atë që ato duan të thonë. Ato pyetën, "A mund të qëndisim atë se si ne hipëm në traktor dhe burrat na i morën"? Dhe ne thamë, "Po". Kështuqë tani është bërë projekti i tyre. Kemi marrë disa fonde për ta zhvilluar atë në një festival mbase vitin tjetër. Njerëz të tjerë kanë shfaqur interes, një repart psikiatrik dëshiron ta përdorë atë si formë të terapisë, kështuqë ky do të jetë një projekt i cili do të rritet dhe artistët do të bëjnë vizuele diçka shumë të fuqishme. Gjithçka filloi me një poezi të shkruajtur nga fëmijët në Manchester pas evakuimit të tyre, pastaj ne kishim disa histori të hershme gojore, tani fjalët e vetë grave. Dhe ato nuk janë të gjitha për vuajtje dhe përpjekje, ndonjëherë ato thonë: lule, ylber, flutur, park i paqës, dhe kjo është shumë e dashur për ne, ato po shkruajnë gjëra që nuk lidhen me luftën dhe refugjatët. Ky është vetëm fillimi.